



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 12 dhjetor 2023

**Nga:** Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së  
**Për:** Z. Evetar Zeqiri, Kryeshef Ekzekutiv, KOSTT Sh.A  
Z. Alpin Dogan, Kryeshef Ekzekutiv KEDS SH.A  
Z. Serhat Dinç, Kryeshef Ekzekutiv, KESCO SH.A



Nr. 566123  
Data 12-12-23

**Kopje:** Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë  
Z. Ferat Shala, Kryetar i Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti  
Z. Arben Loshi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit  
Znj. Fëllënëza Xhelili Fiqi, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.A  
Znj. Rudina Heroi-Puka, Drejtoreshë e Departamentit për Shërbim ndaj Konsumatorit, Tarifa dhe Çështje Rregullative, KESCO Sh.A

**Lënda:** Azhurnimet vjetore të të hyrave dhe tarifave për OST/OT, OSSH dhe FSHU

Po ju drejtohem me qëllim të prezantimit të planeve të Zyrës e Rregullatorit për Energji (ZRRE) përkitazi me shqyrtimet dhe azhurnimet vjetore të tarifave të energjisë elektrike, të cilat pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2024, ashtu siç është përcaktuar në Rregullat e të Hyrave të të Licencuarve.

Në muajin mars të vitit 2023, ZRRE ka kryer procesin e shqyrtimit periodik për Periudhën e Tretë Rregullative (PRR3) 2023-2027 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSh). Në kuadër të këtij procesi ZRRE ka vendosur parametrat kryesor të kostove për të parashikuar të Hyrat e Lejuara Maksimale për PRR3. Në pajtim me rregullat e të hyrave, këto parashikime duhen azhurnuar për të marrë parasysh dallimet që ndodhin ndërmjet vlerave të parashikuara ndaj atyre të realizuara. Këto përshtatje barten në vitin vijues, apo dallimet e vitit t-1 barten në vitin t në kuadër të procesit relevant tarifor. Ky shqyrtim do të fillojë me mbledhjen e të dhënave relevante nga të licencuarit. Analiza e ZRRE-së e këtyre të dhënave dhe propozimet e saj do të bëhen publike dhe do të konsultohen para se të merret ndonjë vendim.

Përcaktimi i të hyrave të Furnizuesit me Obligim të Shërbimit Universal (FSHU) bëhet në baza vjetore, respektivisht tarifat për vitin relevant tarifor 2024 marrin parasysh përshtatjet e kostove të vitit 2023. ZRRE është e përkushtuar dhe kërkon përkrahjen tuaj që ky proces të zhvillohet brenda afateve të propozuara. Për të lehtësuar procesin, ZRRE është e gatshme të ofroj sqarime dhe konsultime përmes shkresave apo takimeve kurdo që të jetë e nevojshme.

Në shtojcë të kësaj letre është i përshkruar orari indikativ i procesit të përshtatjeve të rregullta dhe aplikimeve tarifore.

Me respekt,

  
Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së





## Shtojcë: Orari indikativ

Procesi i **përshtatjeve** të të hyrave për të licencuarit e OST/OT dhe OSSH do të kryhet duke u bazuar në Rregullat për të Hyrat e OST/OT dhe OSSH-së, përkatësisht sipas Shtojcës 7.

### Orari indikativ:

OST/OT dhe OSSH deri më 22 janar 2024 do të ofrojnë të dhënat si më poshtë:

- Përshtatjet e kostove të humbjeve;
- Përshtatjet për OPEX;
- Përshtatjet për kostot e bartshme;
- Përshtatjet për faktorin korigjues të të hyrave; dhe
- Përshtatje tjera të definuara në Rregullat e të Hyrave të OST/OT dhe OSSH-së.

Të licencuarit duhet të dërgojnë të dhënat në bazë të formateve që aplikohen nga ZRRE për shqyrtime tarifore.

Rregullatori do ta njoftojë OST/OT-në dhe OSSH-në 40 dite pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant lidhur me vlerësimin e tij për OST/OT-në dhe OSSH, përkatësisht më datë 5 shkurt 2024. Pas vlerësimit përfundimtar lidhur me përshtatjet e vitit 2023 dhe vlerësimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2024, OST/OT dhe OSSH duhet që deri më datën 8 mars 2024 të dorëzojnë propozimet për tarifa.

Procesi i **aplikimit** për të hyra të lejuara maksimale dhe përshtatje për FSHU-në është i ndarë në tri faza sipas Shtojcës 3 të Rregullës për të Hyrat e Furnizuesit me Shërbim Universal.

FSHU deri më 22 janar 2024 do të paraqes te Rregullatori të dhënat për kostot aktuale dhe parashikimet si më poshtë:

- Kostot e blerjes së energjisë elektrike;
- Kostot me pakicë;
- Propozimi për të hyra për FSHU.

Rregullatori do ta njoftojë FSHU-në 40 ditë pune para fillimit të vitit të ardhshëm relevant lidhur me vlerësimin e tij për FSHU-në, përkatësisht më datë 5 shkurt 2024.

Pas vlerësimit përfundimtar lidhur me përshtatjet e vitit 2023 dhe vlerësimit të të hyrave të lejuara maksimale për vitin 2024, FSHU duhet që deri më datën 8 mars 2024 të dorëzojnë propozimet për tarifa me pakicë për konsumatorët me të drejtë të Furnizimit me Shërbim Universal.

Bilanci i energjisë elektrike i realizuar dhe i parashikuar duhet të jenë pjesë e aplikacioneve të të licencuarve. ZRRE i inkurajon të gjithë të Licencuarit që të harmonizojnë të dhënat e tyre ashtu që të mos ketë devijime lidhur me raportimet e tyre.

Për shkak të transparencës, ZRRE do të publikojë në tërësi aplikacionet e të licencuarve, krahas vlerësimeve të tyre. Prandaj, të licencuarit duhet të identifikojnë ndonjë pjesë të cilën e konsiderojnë si konfidenciale.